



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE

V E N D I M

Nr. 761, datë 23.9.2020

P Ë R

**NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.307, DATË 16.4.2020,
TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR PËRDORIMIN E FONDIT
TË RINDËRTIMIT, PËR FINANCIMIN E RIKONSTRUKSIONIT
DHE NDËRTIMIT TË INFRASTRUKTURËS PUBLIKE,
NË FUNKSION TË RINDËRTIMIT TË BANESAVE INDIVIDUALE
DHE CAKTIMIN E FONDIT SHQIPTAR TË ZHVILLIMIT SI NJËSI
ZBATUESE”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 13, shkronja “b”, nënndarja “i”, 16 dhe 36, të aktit normativ nr.9, datë 16.12.2019, të Këshillit Ministrave, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, miratuar me ligjin nr.97/2019, të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr.88/2019, “Për buxhetin e vitit 2020”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shtetit për Rindërtimin, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Pika 3, e vendimit nr.307, datë 16.4.2020, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, ndryshohet, si më poshtë vijon:
 - “3. Përdorimi i fondit, i miratur në buxhetin e vitit 2020, do të jetë në masën 2 477 077 257 (dy miliardë e katërqind e shtatëdhjetë e shtatë milionë e shtatëdhjetë e shtatë mijë e dyqind e pesëdhjetë e shtatë) lekë pa TVSH, nga të cilat:
 - a) Fondit Shqiptar të Zhvillimit, në buxhetin e miratuar për vitin 2020, në zërin “Shpenzime kapitale me financim të brendshëm”, të programit 06210 “Programe zhvillimi”, i shtohet fondi në masën 795 080 370 (shtatëqind e nëntëdhjetë e pesë milionë e tetëdhjetë mijë e treqind e shtatëdhjetë) lekë pa TVSH, për financimin e ndërtimit dhe të rikonstruksionit të

infrastrukturës publike në zonat e reja të shpallura për zhvillim, në bashkitë Tiranë, Durrës, Kavajë, Krujë, Kurbin, Lezhë, Shijak e Vorë.

- b) Bashkisë Tiranë i transferohet fondi në masën 1 681 996 887 (një miliard e gjashtëqind e tetëdhjetë e një milionë e nëntëqind e nëntëdhjetë e gjashtë mijë e tetëqind e tetëdhjetë e shtatë) lekë pa TVSH, në formën e transfertës së pakushtëzuar, për financimin e ndërtimit dhe të rikonstruksionit të infrastrukturës publike në zonat e reja të shpallura për zhvillim, në Bashkinë Tiranë.”.
2. Ngarkohen ministri i Shtetit për Rindërtimin, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Fondi Shqiptar i Zhvillimit dhe Bashkia Tiranë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në “Fletoren zyrtare”.

K R Y E M I N I S T R I

EDI RAMA

Në mungesë dhe me porosi

ZËVENDËSKRYEMINISTRI

ERION BRAÇE

**MINISTRI I SHETIT
PËR RINDËRTIMIN**

ARBEN AHMETAJ